



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*

prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet se zona zgjedhore ku do të zbatohet projekti pilot, bëhet me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Propozohet caktimi i Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë ku do të zbatohet projekti pilot, për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar, të datës 6 Mars 2022. Projekti pilot i votimit dhe numërimit të votave u zbatua për herë të parë në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, në ZAZ nr. 40 Qarku Tiranë. Në zbatim të nenit 22 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me teknologjinë në zgjedhje, do të zbatohet e njejta procedurë për fazën pasuese të implementimit të këtij projekti në Bashkinë Vorë, Qarku Tiranë, në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Meqenëse, me përfaqësuesit dhe partitë politike e kemi dakordësinë për zbatimin e projektit elektronik në këtë njësi, vendosim ta miratojmë, duke e aplikuar procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, në Bashkinë Vorë, Qarku Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Çështje të tjera nuk kemi!? Mirë, seanca mbyllet!

**Vendimi nr. 48**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



10.02.2022  
Ora 18:04

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, z. Ferdinand Shefqet Saraçi, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

**PJESËMARRJA :**


- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I . Celibashi:** Fillojmë seancën publike me këtë rend dite, jaqnë dhjetë projektvendime të cilat lidhen me verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit për kandidatët për kryetarë në gjashtë bashki: Ferdinand Saraçi, Dritan Torba, Edison Memolla, Hekuran Khani, Premtim Kryemadhi, Lulëzim Vrana, Rahim Spahiu, Blerim Shera, Luan Haka dhe Ymer Marku.

**Z. Y. Merkaj:** Zoti Komisioner, janë tre bashki Vora, Rrogozhina dhe Dibra. Mirë, atëherë, fjala për Sekretarin, për të relatuar projektaktin.

**Z. I . Celibashi:** Po, po, tek relatimet do të na i prezantoni, thjesht lexova emrat. Ferdinand Saraçi është për Rrogozhinën, Dritan Torba është për Dibrën, por shkurtimisht për secilin.

*Zbardhi materialin audio*  
**Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*

**Z. Y. Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 33, datë 2.2.2022, “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, ka regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, “Partia Demokratike”, me kryetar zotin Lulzim Basha. Në zbatim të nenit 67, pika 1, neneve 72 dhe 165, pika 1, të Kodit Zgjedhor “Partia Demokratike”, ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e zotit Ferdinand Shefqet Saraçi, si kandidat për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, i cili ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak rezulton se kandidati për kryetar bashkie zoti Ferdinand Saraçi, ka deklaruar në rubrikën nr.1 “Të dhëna personale”, ndryshimin e gjeneraliteteve, emrin nga “Fredri” në “Ferdinand”. Gjithashtu ka deklaruar në “Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit” se ka qenë i dënuar nga Gjykata CHIETI Itali, për veprën penale “Armbajtje pa leje në banesë”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të shkresës sonë Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin zotin Ferdinand Saraçi, i cili rezulton se nuk ka të regjistruara dënime penale dhe figuron i “pa dënuar”. Referuar ligjit, nr. 138/2015, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, zoti Ferdinand Shefqet Saraçi, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Referuar nenit 33, shkronja “f” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*

bashki të cilat administrohen nga një KZAZ. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Nuk kemi! Mirë, atëherë, bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e pika 2, nenin 67, pika 2, nenin 72, nenin 73, nenin 165, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, udhëzimit nr. 01 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe e vendimin nr. 2, datë 22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme në këto bashki”, vendos:

1. Kandidati për kryetar bashkie, zoti Ferdinand Shefqet Saraçi, propozuar nga “Partia Demokratike”, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të bashkisë Rrogzhinë, të datës 6 Mars 2022, nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 43, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Ferdinand Shefqet Saraçi, propozuar nga “Partia Demokratike”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 49**

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



10.02.2022  
Ora 18:09

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Dibër, z. Dritan Hajri Torba, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me referimin për kandidatin Dritan Torbja!

**Z. Y. Merkaj:** Partia Lëvizja e Re është regjistruar si subjekt zgjedhor me vendimin nr. 35, datë 2.2.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e zotit Dritan Hajri Torbja, si kandidat për kryetar në Bashkinë Dibër, i cili ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak rezulton se kandidati nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalimet në Ligjin 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të shkresës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin zotin Dritan Hajri Torba, i

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*

cili rezulton se nuk ka të regjistruara dënime penale të formës së prerë. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Referuar nenit 33, shkronja “f” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Dakord!! Mirë, atëherë, edhe për,

1. Kandidatin për kryetar bashkie, zotin Dritan Hajri Torba, propozuar nga “Partia Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të bashkisë Dibër, të datës 6 Mars 2022, konstatojmë se nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 19, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Dritan Hajri Torbja, propozuar nga “Partia Lëvizja e Re”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 50**

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



10.02.2022

Ora 18:11

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, z. Edison Selman Memolla, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me referimin për kandidatin Edison Memolla!

**Z. Y. Merkaj:** Partia Socialiste është regjistruar si subjekt zgjedhor me vendimin nr. 35, datë 2.2.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e zotit Edison Selman Memolla, si kandidat për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, i cili ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak rezulton se kandidati nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalimet në Ligjin 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të shkresës sonë Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin zotin Dritan Hajri Torba, i

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*


cili rezulton se nuk ka të regjistruara dënime penale të formës së prerë, pra figuron “i padënuar”. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, të datës 6 Mars 2022. Referuar nenit 33, shkronja “f” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Dakord!! Mirë, atëherë, vendosim,

1. Kandidati për kryetar bashkie, zoti Edison Selman Memolla, propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, të datës 6 Mars 2022, se nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 43, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Edison Selman Memolla, propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 51**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



10.02.2022  
Ora 18:13

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, z. Hekuran Selman Xhani, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

**PJESËMARRJA :**


- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me referimin për kandidatin Hekuran Selman Xhani!

**Z. Y. Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 46, datë 4.2.2022 ka regjistruar si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në koalicion për zgjedhjet për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, kolacionin e partive politike LSI dhe PDK. Partia udhëheqëse e koalicionit është Partia Lëvizja Socialiste për Integrim e cila ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e zotit Hekuran Selman Xhani, si kandidat për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, i cili ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak rezulton se kandidati nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalimet në Ligjin 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të shkresës sonë Drejtoria e

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*

Përgjithëshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, zotin Hekuran Selman Xhani, i cili rezulton se nuk ka të regjistruara dënime penale të formës së prerë, pra figuron “i padënuar”. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022. Referuar nenit 33, shkronja “f” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe formularin e vetëdeklarimit, faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Dakord!! Mirë, atëherë, vendosim,

1. Kandidati për kryetar bashkie, zoti Hekuran Selman Xhani, propozuar nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, të datës 6 Mars 2022, nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 43, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Hekuran Selman Xhani, propozuar nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 52**

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



10.02.2022  
Ora 18:15

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Dibër, z. Premtim Riza Kryemadhi, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

**PJESËMARRJA :**


- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2. Staf i KQZ:                                      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**                                      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me referimin për kandidatin Premtim Riza Kryemadhi!

**Z. Y. Merkaj:** Në zbatim të nenit 67, pika 1, nenit 72 dhe 165 të Kodit Zgjedhor, Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e zotit Premtim Riza Kryemadhi, si kandidat për kryetar në Bashkinë Dibër, i cili ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak i formularit të vetëdeklarimit rezulton se kandidati nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalimet në Ligjin 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të shkresës sonë Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar të Bashkisë Dibër, zotin

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*


Premtim Riza Kryemadhi, i cili rezulton se nuk ka të regjistruara dënime penale të formës së prerë, pra figuron “i padënuar”. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Dibër, për zgjedhjet e pjeshme vendore të datës 6 Mars 2022. Referuar nenit 33, shkronja “f” e Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për ato bashki që administrohen nga një KZAZ, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Dakord!! Mirë, atëherë, vendosim,

1. Kandidati për kryetar bashkie, zoti Premtim Riza Kryemadhi, propozuar nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar të Bashkisë Dibër, të datës 6 Mars 2022, nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 19, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Premtim Riza Kryemadhi, propozuar nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 53**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



10.02.2022  
Ora 18:18

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Vorë, z. Lulëzim Sefer Vrana, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2. Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me referimin për kandidatin Lulëzim Sefer Vrana!

**Z. Y. Merkaj:** Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e zotit Lulëzim Sefer Vrana, si kandidat për kryetar në Bashkinë Vorë, i cili ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak i formularit të vetëdeklarimit rezulton se kandidati nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalimet në Ligjin 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të shkresës sonë Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar të Bashkisë Vorë, zotin Lulëzim Sefer Vrana, i cili rezulton se nuk ka të regjistruara dënime

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*


penale të formës së prerë, pra figuron “i padënuar”. Referuar ligjit 138/2015, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit Lulëzim Sefer Vrana për kryetar të Bashkisë Vorë, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022. Referuar nenit 33, shkronja “f” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për ato bashki që administrohen nga një KZAZ. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Nuk kemi diskutime! Atëherë, vendosim,

1. Kandidati për kryetar bashkie, zoti Lulëzim Sefer Vrana, propozuar nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të Bashkisë Vorë, të datës 6 Mars 2022, nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 26, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Lulëzim Sefer Vrana, propozuar nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 54**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



10.02.2022  
Ora 18:20

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Dibër, zotit Rahim Petrit Spahiu, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2. Staf i KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me referimin për kandidatin Rahim Petrit Spahiu!

**Z. Y. Merkaj:** Partia Socialiste e regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e zotit Rahim Petrit Spahiu, si kandidat për kryetar në Bashkinë Dibër, i cili ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak i formularit të vetëdeklarimit rezulton se kandidati Rahim Petrit Spahiu nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalimet në Ligjin 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të shkresës sonë Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*

Bashkisë Dibër, zotin Rahim Petrit Spahiu, i cili rezulton se nuk ka të regjistruara dënime penale të formës së prerë, pra figuron “i padënuar”. Referuar ligjit 138/2015, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit Rahim Petrit Spahiu për kryetar të Bashkisë Dibër, për zgjedhjet e pjeshme vendore të datës 6 Mars 2022. Referuar nenit 33, shkronja “f” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për ato bashki që administrohen nga një KZAZ. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Nuk kemi diskutime!  
Atëherë, vendosim,

1. Kandidati për kryetar bashkie, zoti Rahim Petrit Spahiu, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar të Bashkisë Dibër, të datës 6 Mars 2022, nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 19, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Rahim Petrit Spahiu, propozuar nga Partia Socialiste.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 55**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**10.02.2022  
Ora 18:22**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Vorë, zotit Blerim Rustem Shera, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me referimin për kandidatin Blerim Rustem Shera!

**Z. Y. Merkaj:** Partia Socialiste e regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e zotit Blerim Rustem Shera, si kandidat për kryetar në Bashkinë Vorë, i cili ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak i formularit të vetëdeklarimit rezulton se kandidati Blerim Rustem Shera nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalimet në Ligjin 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*

Bashkisë Vorë, zotin Blerim Rustem Shera, i cili rezulton se nuk ka të regjistruara dënime penale të formës së prerë, pra rezulton “i padënuar”. Referuar ligjit 138/2015, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacioni të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit Blerim Rustem Shera për kryetar të Bashkisë Vorë, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022. Referuar nenit 33, shkronja “F” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për ato bashki që administrohen nga një KZAZ. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike nuk kanë kontribute. Atëherë, vendosim,

1. Kandidati për kryetar bashkie, zoti Blerim Rustem Shera, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të Bashkisë Vorë, të datës 6 Mars 2022, nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 26, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Blerim Rustem Shera, propozuar nga Partia Socialiste.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 56**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



10.02.2022  
Ora 18:24

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Dibër, zotit Luan Qamil Haka, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me referimin për kandidatin Luan Qamil Haka!

**Z. Y. Merkaj:** Partia Demokratike e regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e zotit Luan Qamil Haka, si kandidat për kryetar në Bashkinë Dibër, i cili ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak i formularit të vetëdeklarimit rezulton se në rubrikën “Të dhënat gjyqësore të personit” ka deklaruar se ka qenë i ndaluar, apo arrestuar... në vitin 2015 ka qenë i ndaluar nga Policia e Tiranës për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të policisë”. Nga Policia e Peshkopisë është shpallur në kërkim policor në datën 29.06.2019 “për organizimin e protestës së opozitës”, për të cilën është revokuar edhe urdhëri i kërimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*


gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar të Bashkisë Dibër, zotin Luan Qamil Haka, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem, pra rezulton “i padënuar”. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacioni të ardhur nga Drejtoria e Përgjithëshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit Luan Qamil Haka për kryetar të Bashkisë Dibër, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike nuk kanë diskutime. Atëherë, vendosim,

1. Kandidati për kryetar bashkie, zoti Luan Qamil Haka, propozuar nga Partia Demokratike, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të Bashkisë Dibër, të datës 6 Mars 2022, nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 19, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Luan Qamil Haka, propozuar nga Partia Demokratike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 57**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**10.02.2022  
Ora 18:26**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Vorë, zotit Ymer Gjergio Marku, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.**


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2. Stafi KQZ:**      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me referimin për kandidatin Ymer Gjergio Marku!

**Z. Y. Merkaj:** Partia Demokratike e regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, ka depozituar në KZAZ, kërkesën për regjistrimin e zotit Ymer Gjergio Marku, si kandidat për kryetar në Bashkinë Vorë, i cili ka depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi paraprak i formularit të vetëdeklarimit rezulton se në rubrikën “Të dhëna personale” ka ndryshuar gjeneralitetet. Nga emri “Imer” ka ndryshuar në “Ymer” dhe atësia nga “Han” në “Gjergio”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*


kandidatin për kryetar të Bashkisë Vorë, zotin Ymer Gjiergio Marku, i cili rezulton se nuk ka të regjistruara dënime penale të formës së prerë, pra rezulton “i padënuar”. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacioni të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit Ymer Marku për kryetar të Bashkisë Vorë, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022. Referuar nenit 33, shkronja “F” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për ato bashki që administrohen nga një KZAZ. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike nuk kanë diskutime. Atëherë, vendosim,

1. Kandidati për kryetar bashkie, zoti Ymer Gjiergio Marku, propozuar nga Partia Demokratike, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të Bashkisë Vorë, të datës 6 Mars 2022, nuk është në kushtet e moskandidimit.
2. KZAZ nr. 26, të vijojë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, zotit Ymer Gjiergio Marku, propozuar nga Partia Demokratike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 58**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



10.02.2022  
Ora 18:28

**JASHTË RENDIT TË DITËS**

**PJESËMARRJA :**


- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staffi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**

**Z. I. Celibashi:** Çështje të tjera? Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi, faleminderit edhe për kryerjen e kësaj procedure në mënyrë të shpejtë. Në fakt kam tre çështje të cilat do t'i adresoj shkurtimisht. Së pari, siç e dini, në datën 2 shkurt, ne kemi adresuar një problematikë që ka të bëjë me shpërndarjen e fondeve të rindërtimit nga ana e Bashkisë Durrës. Në datën 3 shkurt nëpërmjet shkresës së protokollit nr. 502, ju keni kërkuar informacion lidhur me këtë denoncim drejtuar zyrtarisht Bashkisë Durrës për dijeni Partisë Demokratike, duke kërkuar që informacioni të sillet brenda tre ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese. Duam të dimë nëse ka pasur një përgjigje zyrtare nga ana e Bashkisë Durrës në lidhje me këtë kërkesë?

**Z. I. Celibashi:** Akoma nuk kemi marrë! Deri në momentin që po flasim akoma nuk kemi një përgjigje, ndërkohë të gjejmë dhe mënyra të tjera të komunikimit. E para, për t'u siguruar që e kanë marrë shkresën dhe e dyta për të kthyer përgjigje brenda afatit. Qoftë dhe një komunikim telefonik.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Çështja e dytë zoti Komisioner, ne pak më parë kemi miratuar procedurën për hedhjen e shortit në lidhje me renditjen e subjekteve në fletën e votimit. Nga ana tjetër, akoma po themi, kandidatët të paktën që regjistrohen nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk u është bërë regjistrimi zyrtarisht. Do të kërkonim që edhe për shkak të afateve që janë goxha të shkurtëra, për sa i takon fushatës, por dhe gjithë veprimtarive si të subjekteve zgjedhore, po ashtu dhe kandidatëve, sigurisht dhe njohjes së votuesve me kandidatët. Në qoftë se është e mundur brenda ditës së nesërme, në një kohë sa më të shpejtë të procedojmë edhe me regjistrimin e kandidatëve, edhe më pas me hedhjen e shortit për sa i përket mënyrës se si do të renditen kandidatët në fletët e votimit. Në mënyrë që të kemi qartësi dhe informacion për kandidatët por dhe për votuesit. Kjo si kërkesë që brenda mundësive të kryhet në një kohë sa më të shpejtë ditën e nesërme. Çështja e tretë në fakt më është adresuar nga kandidati i Partisë Demokratike në Bashkinë Dibër, zoti Luan Haka. Kjo ka të bëjë me faktin që nga takimi që ka pas, një pjesë e konsiderueshme për të cilën ai më ka siguruar që do të më verë në dispozicion edhe të dhëna konkrete, rezulton se në këtë zonë zgjedhore, ka një numër të konsiderueshëm zgjedhësish të cilëve karta e identitetit, ose mjeti i identifikimit u ka përfunduar. Do të doja të dija, ose të diskutoja lidhur me këtë kategori, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, eventualisht të mund të shohim bashkarisht edhe mundësinë për ta adresuar këtë problematikë për t'i dhënë një lloj zgjidhje. Në mënyrë që në qoftë se problematika është e shtrirë dhe përfshin një numër të konsiderueshëm qytetarësh, të mos krijohet si pengesë pamundësia e këtyre qytetarëve për të votuar në zgjedhjet e 6 marsit, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022**

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, po ia drejtojmë këtë kërkesë Ministrisë së Brendshme dhe në mënyrë të posaçme Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për të marrë një informacion mbi vlefshmërinë e dokumenteve të identifikimit të zgjedhësve në Bashkinë e Dibrës. Gjithësesi nëse e keni konstatuar..., besoj se do ta keni konstatuar, në mënyrë të vazhdueshme që në ditën e parë që ne filluam të përgatitemi për këto zgjedhje, kemi adresuar thirrjen që votuesit e këtyre bashkive të verifikojnë vlefshmërinë e dokumenteve të identifikimit, sepse nuk do të jetë rasti që vlefshmëria e këtij dokumenti do të shtyhet. Varet dhe nga graviteti i problemit në çdo rast, por gjithësesi duhet ta mbajmë në vëmendje. Ne si institucion përgjegjës për përgatitjen dhe administrimin e procesit zgjedhor, por mendoj se do të ishte e dobishme dhe nga ana e partive politike që votuesve potencialë të tyre t'u sillej në vëmendje fakti që duhet të verifikojnë vlefshmërinë e dokumenteve të tyre të identifikimit. Nuk do të ishte shumë e dobishme që sa herë ka zgjedhje, përjashtoj zgjedhjet e përgjithshme që mund të ketë ndonjë përjashtim, dokumenteve të identifikimit t'u shtyhet afati i vlefshmërisë në mënyrë mekanike në një lloj mënyre.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Patjetër, kjo është arsyeja që unë po kërkoj që KQZ-ja të mbledhë të dhëna empirike për të parë se sa serioze dhe e shtrirë është kjo si problematikë dhe pastaj në varësi të kësaj të kemi mundësi, meqenëse është rasti dhe për ta adresuar. Qoftë nëpërmjet një fushate edhe të KQZ-së, por dhe të subjekteve politike që qytetarët të paisen me kartat e identitetit në afate, ose po themi brenda ndonjë mekanizmi tjetër, brenda kuadrit ligjor, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po faleminderit! Ne nesër, se sot objektivisht nuk është e mundur, do ta bëjmë këtë komunikim me Ministrinë e Brendshme, me Drejtorinë e

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.10.02.2022*

Përgjithshme të Gjendjes Civile, për të marrë prej tyre një informacion. Dakord!  
Tjetër?!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Pa mikrofon!

**Z. I. Celibashi:** Edhe ne kemi interes të procedojmë sa më shpejt, sepse përfundimi i procesit të shortimit të kandidatëve në fletët e votimit, na jep mundësinë të fillojmë procedurat për printimin e fletës së votimit. Për sa i takon atyre njësitë të qeverisjes vendore, kandidatët e të cilëve regjistrohen në KQZ, ne mund ta bëjmë këtë, do të duhet të presim nga KZAZ-të. Jemi në komunikim me KZAZ-të, pas vendimmarrjes së sotme, ato e kanë rrugën e hapur për të proceduar me regjistrimin. Besoj se nesër do t'i mbyllim të dyja procedurat. Nq qoftë se do të arrijmë t'i bëjmë bashkë për të gjashta jemi shumë mirë. Nëse jo?! Nëse biem dakord të gjithë mundet ta bëjmë shortin për tre bashkitë kandidatët e të cilëve regjistrohen në KQZ, pra të bëjmë fillimisht ato, pastaj shortin për të tjerët. Po e shohim nesër situatën, por në princip jemi dakord që në momentin që do të përfundojmë me regjistrimin të bëjmë shortin menjëherë. Ndoshta dhe brenda një seance në mënyrë suksesive, dakord?! Në rregull, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

